

TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA NË NIVEL VENDOR

VLERËSIMI I PROCESEVE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË DURRËS 2024

PËRGATITUR NGA:

**QENDRA E ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË CIVILE
RRJETI PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE**

Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik

Bashkia Durrës

Përgatiti: Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile, Durrës

Korrik 2024

Tabela e Përmbajtjes

TABELA E PËRMBAJTJES	3
1. LISTA E SHKURTIMEVE	4
2. HYRJE	5
3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E STUDIMIT	7
4.METODOLOGJIA E STUDIMIT	8
5. KUADRI LIGJOR NË NIVEL VENDOR	11
6. PËRSHKRIMI I STRUKTURËS SË QEVERISJES LOKALE NË BASHKINË DURRËS	12
7. HISTORIKU I PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË DURRËS	14
8. VLERËSIMI I EFEKTIVITETIT DHE TRANSPARENCËS SË PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK	15
8.1 Gjetje nga intervistat e realizuara me staf të bashkisë Durrës	20
8.2 Gjetje nga intervistat e zhvilluara me anëtarë të Këshillit Bashkiak	22
9. PËRMBLEDHJE E KOMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE TË GRUPEVE TË INTERESIT E QYTETARËVE NGA KONSULTIMI PUBLIK	26
9.1 Intervistat e thelluara me grupet e interesit	26
9.2 Perceptimet e qytetarëve përmes vlerësimit online	28
10. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	32
11. REFERENCA	34
12. ANEKSE	35
Aneksi 1. Kërkesë Zyrtare drejtuar Bashkisë Durrës	35
Aneksi 2. Pyetësi i Intervistave të thelluara me stafin e Bashkisë Durrës	35
Ankesi 3. Pyetësi i Intervistave të thelluara me anëtarët e Këshillit Bashkiak Durrës	35
Ankesi 4. Pyetësi i Intervistave të thelluara me grupet e interesit	35
Ankesi 5. Pyetësi për qytetarët online	35

1. Lista e Shkurtimeve

AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
BP	Buxhetimi me Pjesëmarrje
CSDC	Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile
KB	Këshilli Bashkiak
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
NED	National Endowment for Democracy
Nj.A	Njësi Administrative
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Palme International Center
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Projekt Buxheti Afatëmesëm
POP	Përballja e Ofertave Politike
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak

2. Hyrje

Angazhimi dhe përfshirja e qytetarëve në konsultim dhe vendimmarrje përbën një nga elementët kryesorë drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë, ku zëri i të gjithëve dëgjohet gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes organizatave të shoqërisë civile tek institucionet përgjegjëse. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve garanton identifikimin e problemeve dhe nevojave reale, përfshirjen e njohurive dhe përvojave të të gjithë aktorëve, duke i bërë ata të ndihen përgjegjës për çështje të përbashkëta, duke rritur besueshmërinë dhe transparencën dhe krijimin e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme.

Roli dhe kontributi i pazëvendësueshëm i qytetarëve dhe komuniteteve në proceset qeverisëse është kyç për arritjen e një qeverisjeje sa më demokratike, ndërkohë që bashkitë përmes zbatimit efektiv të ligjit dhe politikave të duhura e gjithëpërfshirëse sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm, përfshirje dhe kohezion social.

Është misioni i qeverisjes vendore të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve të saj dhe të nxisë pjesëmarrjen e tyre efektive në të, ndërkohë që ushtrimi i qeverisjes dhe përmirësimi i cilësisë së jetës nuk mund dhe nuk duhet të jenë e drejtë ekskluzive e saj. Për sa kohë që ekzistojnë mekanizma dhe modele të mirëqeverisjes, bashkitë duhet të vijojnë të kërkojnë, adaptojnë e praktikojnë alternativa dhe forma ku qytetarët, grupet e interes dhe shoqëria civile shihen si partnerë të domosdoshëm të këtij procesi.

Studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik” zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Ai zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike”¹ (POP) në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financiar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center.

Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Organizatave anëtare të Rrjetit POP, veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikën dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Nën këtë optikë në periudhën maj – qershor 2024, është realizuar studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik”. Studimi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara² për periudhën shtator 2023 – maj 2024, për të

¹ Faqe zyrtare e Rrjetit POP: <https://popNetwork.al/>

² Tiranë, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

pasqyruar situatën e realizimit të

njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore. Gjetjet dhe rekomandimet do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të ligjit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe rastet e suksesit në zbatimin e tij. Rrjeti POP në një fazë të mëvonshme do të punojë dhe me institucionet mbikqyrëse për të ndarë gjetjet e studimit, siç janë Prefekturat, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.”

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë; • Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; • Qendra Rinore Vlorë, • Epoka e Re, Fier; | <ul style="list-style-type: none"> • Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; • Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; • Qendra Rinore për Progres, Kukës, • Gruaja në Zhvillim, Korçë; • Hapa të Lehtë, Vau i Dejës; • Tjetër Vizion, Elbasan |
|--|---|

3. Përmbledhje Ekzekutive e Studimit

Përgatitja e këtij raporti është bërë nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center. Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Në Durrës, studimi është përgatitur nga Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC)³, organizatë anëtare e Rrjetit POP, me synimin kryesor që organizatat lokale të veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikat dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik në Vlorë” vlerësoi situatën e realizimit të Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik për periudhën shtator 2023 – maj 2024, përmes monitorimit të dëgjësave publike duke nxitur diskutimin midis aktorëve të përfshirë për njohjen dhe zbatimin e ligjit, si dhe përgatiti disa rekomandime konkrete në nivel të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore (NjVQV)

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në vendimmarrje përfaqëson një nga format kryesore të angazhimit të qytetarëve në jetën publike. Kjo arrihet përmes mjeteve dhe mekanizmave që NjVQV ushtrojnë, në përputhje me Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik⁴ duke vënë në dispozicion të qytetarëve, hapësira dhe mundësi për t'i përfshirë ata në formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe shërbimeve për komunitetin. Pavarësisht se të gjithë të intervistuarit e vlerësonin rëndësinë e proceseve konsultuese dhe gjithëpërfshirëse, realizimi efektiv i tyre në nivel vendor mbetet ende një sfidë.

Ky studim ka për qëllim të vlerësojë efektivitetin dhe transparencën e procesit të konsultimit publik në Bashkinë Durrës. Objektivat kryesore përfshijnë analizën e nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve, cilësinë e informacionit të mbledhur dhe mënyrën e komunikimit të rezultateve të konsultimeve.

Gjetjet kryesore tregojnë se:

- Bashkia ka një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik, dhe detyrat e tij janë të përfshira në rregulloren e funksionimit dhe organizimit të Bashkisë Durrës. Të dhënat e tij janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit.

³ Faqe zyrtare në Facebook: <https://www.facebook.com/CivilSocietyDevelopmentCenterDurrës>

⁴ Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://qbz.gov.al/eli/ligji/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

- Ekzistojnë sfida në përfshirjen e qytetarëve në proceset e njoftimit dhe konsultimit publik, të cilat rrjedhin si nga indiferenca qytetare për pjesëmarrje dhe angazhim, ashtu edhe nga zyrtarët lokalë, të cilët duhet të bëjnë më shumë për të informuar dhe konsultuar një numër më të madh qytetarësh dhe grupesh interesi.
- Gjatë vitit 2023, Bashkia Durrës ka realizuar 19 konsultime publike, ku kanë marrë pjesë grupe interesi, OJF-të, qytetarë, dhe të tjerë. Nga këto, 18 konsultime janë zhvilluar për Programin e Buxhetit Afatmesëm 2024-2026, ndërsa 1 konsultim publik është realizuar për zgjedhjen e komisioneve të Këshillit Bashkiak.
- Faqja e internetit ofron akses në informacion dhe projektakte që duhet t'i nënshtrohen procedurës së njoftimit dhe konsultimit publik.
- Është e nevojshme që Bashkia të krijojë platforma interaktive për konsultime publike, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në këto procese.
- Operimi me regjistrë elektronik është një hap pozitiv, por janë të nevojshme përmirësime të mëtejshme në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe në përmirësimin e infrastrukturës së informimit.

Gjetjet kryesore tregojnë se, ndonëse janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të përmirësuar transparencën, ende ekzistojnë sfida të mëdha në përfshirjen gjithëpërfshirëse të qytetarëve dhe në sigurimin e aksesit të lehtë në informacion. Raportet vjetore dhe regjistri elektronik janë hapa pozitivë, por janë të nevojshme përmirësime të mëtejshme në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe në përmirësimin e infrastrukturës së informimit. Përfundimisht, raporti rekomandon që Bashkia Durrës të intensifikojë përpjekjet për trajnimin e nëpunësve dhe anëtarëve të Këshillit Bashkiak mbi detyrimet ligjore për transparencën, të zhvillojë fushata më të gjera informimi, dhe të krijojë platforma interaktive për të përmirësuar procesin e konsultimit publik. Në përfundim, rekomandohet që Bashkia Durrës të intensifikojë përpjekjet për trajnimin e nëpunësve mbi Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, dhe të sigurojë që anëtarët e Këshillit Bashkiak të njohin dhe të realizojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në lidhje me konsultimin e qytetarëve.

4. Metodologjia e Studimit

Për përgatitjen e vlerësimit në lidhje me zbatimin e Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit publik (ligji nr. 146/20145) në bashkinë Durrës, Rrjeti POP kombinoi një sërë mjetesh dhe metodologjish duke përfshirë:

- Rishikimi i dokumenteve strategjike, publikimeve në regjistrin elektronik për konsultimet, publikimeve në programin e transparencës, raporteve të prodhuara dhe bazave të të dhënave në të gjitha fazat e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor.

⁵ Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://qbz.gov.al/eli/ligji/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

- Kërkesa zyrtare për informacion drejtuar stafit të Bashkisë Durrës dhe titullarit të saj.
- Trajnim i stafit të CSDC-së mbi Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe plotësimin e pyetësorëve.
- 4 intervista të drejtpërdrejta me stafin e Bashkisë (Nënkryetari i Bashkisë; Koordinatorja për Njoftimin dhe Konsultimin Publik; Koordinatorja për të Drejtën e Informimit dhe Transparencën; përfaqësuese e Drejtorisë së Financës).
- 5 intervista të thelluara me anëtarë të Këshillit Bashkiak (Nënkryetare, Sekretare e KB, Anëtare e Komisionit Juridik, Anëtare e Komisionit të Financave, Anëtare e Komisionit të Peticioneve, Mandateve dhe Rregulloreve).
- 30 intervista të thelluara me aktivistë/përfaqësues të komunitetit dhe qytetarë.
- 111 pyetësorë online të plotësuar nga qytetarë të Bashkisë Durrës (88 femra dhe 23 meshkuj).

Si më sipër e detajuar, metodologjia e përdorur përfshiu mbledhjen e të dhënave përmes pyetësorëve, intervistave me palët e interesuara dhe analizës së dokumenteve zyrtare. Të dhënat u analizuan për të identifikuar praktikrat më të mira dhe sfidat kryesore në procesin e konsultimit.

Burimi kryesor i informacionit në lidhje me shqyrtimin e dokumenteve strategjike, raporteve të prodhuara dhe zbatimit të fazave të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik janë faqet zyrtare të internetit të bashkisë e këshillit bashkiak të përzgjedhura në studim, rregulloret e brendshme dhe publikimi i njoftimeve dhe dokumentacionit lidhur me konsultimet publike të zhvilluara, por edhe raportet e prodhuara nga institucione ndërkombëtare apo organizata të shoqërisë civile.

Në lidhje me mekanizmat e kontrollit të zbatimit të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, ekspertët dhe organizatat e përfshira në projekt kanë hulumtuar dokumentet e prodhuara nga institucionet që monitorojnë drejtpërdrejtë zbatimin e ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik si institucioni i Prefektit, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale.

Për përgatitjen e studimit ekspertët e projektit hartuan kërkesa për informacion drejtuar kryetarit të bashkisë e stafeve bashkiakë të NJVQV, pyetësorë dhe intervista të thelluara me koordinatoren e njoftimit dhe konsultimit publik, sekretariatit e këshillit bashkiakë dhe aktivistë, qytetarë e përfaqësues të OSHC-ve. Pyetësorët përmbajnë pyetje rreth temave që lidhen me: urdhërat e brendshëm për fillimin e procedurës së konsultimit publik; përgatitja dhe publikimi i kalendarit të konsultimit publik; njoftimi i konsultimit publik; realizimi i konsultimit; përgatitja dhe publikimi i procesverbaleve, ndikimi i rekomandimeve të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimet përfundimtare të aprovuara nga vendimarrësit si dhe publikimi i raportit të konsultimit publik në rregjistrin elektronik. Në lidhje me qytetarët dhe grupet e interesit përmes pyetësorëve është vlerësuar efektiviteti i procesit të konsultimit publik, si reflektohen rekomandimet e tyre dhe si ndikon në jetën e qytetarëve vendimet që nuk konsultohen me proces të pjesëmarrëse.

Pyetësorët e shpërndarë

përbajnë pyetje cilësore dhe sasiore duke mbajtur në vëmendje ekspertizën lokale të organizatave të rrjetit POP, në çështje të qeverisjes vendore dhe angazhimit qytetar. Për përgatitjen e pyetësorve ekspertët e organizatave lokale konsideruan faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e sondazhit, të tilla si: objektivi i përgjithshëm i anketimit dhe konteksti lokal (të dhënat informacionet ekzistuese) për të mundësuar një kuptim më të mirë të situatës dhe çështjeve.

Gjithashtu u trajnuan 10 përfaqësues të organizatave lokale, për të zhvilluar intervistat në terren. Intervistat kërkuan të sigurojnë marrjen e informacioneve në aspektin gjeografik, të moshës dhe gjinisë. Intervistuesit zhvilluan intervista të drejtpërdrejta, duke drejtuar pyetjet personalisht dhe duke plotësuar në vend pyetësorët.

Pas përfundimit të intervistave u zhvillua një bazë të dhënash, për t'u përpunuar dhe u analizuar. CSDC përgatiti një raport të hollësishëm të vëzhgimit me gjetjet dhe rekomandimet që do të përdoren në një fazë të mëvonshme për të avokuar për nevojat dhe prioritetet qytetarëve me përfaqësues të institucioneve vendore (Bashkia dhe KB).

Ky raport studimor është një kontribut i rëndësishëm për të kuptuar dhe përmirësuar mënyrat e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen publike, duke synuar një qeverisje më të hapur, transparente dhe të përgjegjshme në Bashkinë Durrës.

Një raport i përbashkët me gjetjet nga 10 bashkitë: Tiranë; Durrës; Elbasan; Vlorë; Fier; Vau i Dejës; Korçë; Pukë; Kukës; Shkodër do të hartohet me metodën krahasuese dhe do të shërbejë për të evidentuar progresin e arritur duke analizuar të dhënat e grumbulluara nga gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e arritura nga raporte të mëparshme duke përdorur indikatorë sasiore dhe cilësore si burime primare⁶ dhe sekondare⁷ për grumbullimin e informacionit.

Gjetjet dhe rekomandimet e raportit do të synojnë përmirësimin e situatës aktuale nëpërmjet masave që autoritetet vendore duhet të ndërmarrin në lidhje me zbatimin e ligjit dhe propozime për ndryshime ligjore për ta bërë procesin sa më interaktiv dhe gjithëpërfshirës.

⁶ Si burime primare të informacionit u përdor ligji nr.146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", informacioni në lidhje me procesin e konsultimi public të publikuar në faqet zyrtare të bashkive respektive si edhe informacioni i përfituar nëpërmjet Kërkesave për Informim.

⁷ Si burime sekondare: u përdorën raporte të tjera në lidhje me procesin e konsultimit të cilat shërbyen në përgatitjen e analizës krahasuese të progresit në çdo bashki në lidhje me procesin e konsultimit.

5. Kuadri ligjor në nivel vendor

Misioni i NJVQV është të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve dhe të nxisë një pjesëmarrje efektive të banorëve në qeverisjen vendore. Transparenca, llogaridhënia dhe përfshirja publike janë parimet themelore për ruajtjen dhe avancimin e demokracisë.

Dialogu ndërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur, si dhe përfshirja e tyre në qeverisjen lokale, janë thelbësore për avancimin e demokracisë lokale, sepse forcohet legjitimiteti dhe efektiviteti i veprimeve të bashkisë dhe këshillit bashkiak. Procesi i konsultimit publik përbën një shtyllë kryesore për një qeverisjeje transparente, duke i mundësuar qytetarëve dhe grupeve të interesit diskutimin, dialogun, monitorimin dhe vlerësimin e punës së pushtetit vendor.

Në vëmendje të këtij studimi është njohja dhe zbatimi në bashkinë Durrës i Ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” që detyrojnë organet e vetëqeverisjes vendore të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendim-marrjes.

Legjislacioni aktual në Shqipëri përcakton detyrimin e bashkive për realizimin e njoftimit dhe konsultimit publik pothuajse për çdo vendim marrje që ato kryejnë. Ndër ligjet kryesore që sanksionojnë detyrimin për angazhimin qytetar në vendim marrjen lokale, më të rëndësishmit janë:

- Ligji Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”
- Ligji Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”
- Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligji Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligji Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”

Duke iu referuar Ligjit Nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, bashkia si organ ekzekutiv dhe Këshilli Bashkiak si organ përfaqësues, kanë detyrimin të sigurojnë transparencën e veprimtarive⁸ të tyre në procesin e vendim marrjes.

Angazhimi i komunitetit në qeverisjen lokale, ndër të tjera, mundësohet përmes konsultimeve publike, duke sjellë në vëmendje përgjegjësitë e organeve vendore të njohin dhe zbatojnë në praktikë detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

⁸ Neni 16 dhe neni 18 i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

6. Përshkrimi i strukturës së qeverisjes lokale në bashkinë Durrës

Informacion i përgjithshëm: Bashkia e Durrësit shtrihet përgjatë bregut të detit, nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri në kufi me Kavajën në jug. Vija e gjatë bregdetare që i shtohet qytetit të Durrësit e thekson tiparin e kësaj bashkie si zonë turistike, pasi përveç plazhit të Durrësit asaj i shtohet i gjithë Gjiri i Lalëzit si dhe Kepi i Rodonit. Durrësi ka gjithashtu, portin më të madh në Shqipëri, ku përpunohet mbi 90 për qind e të gjithë volumit të ngarkim-shkarkimit portual, gjë që e bën atë nyjën më të rëndësishme tregtare në vend.

Sipas dokumentit të PBA, Bashkia e Durrësit është pjesë e Qarkut të Durrësit dhe përbëhet nga 11 njësi administrative, nga të cilat gjashtë janë në qytet dhe pesë janë ish komunat: Sukth, Ishëm, Katund i Ri, Rrashbull dhe Manëz, me gjithsej 39 fshatra. Sipërfaqja totale e Bashkisë Durrës është 338,3 km².

Sipas të dhënave nga Instat, Bashkia Durrës ka 314,496 banorë ose 95,300 familje, ku 65% e popullsisë është urbane. Densiteti i popullsisë është 930 banorë për km². Aktualisht, rreth 508 familje, ose 0.5% e familjeve, përfitojnë ndihmë ekonomike. Gjithashtu, janë të regjistruar rreth 13,700 biznese në total.

Bashkia Durrës gjatë vitit 2023 ka realizuar 19 konsultime publike, ku kanë marrë pjesë grupe interesi, OJF, qytetarë etj. Nga totali i konsultimeve, 18 prej tyre janë zhvilluar për Program Buxhetin Afatmesem 2024-2026 dhe 1 konsultim publik për zgjedhjen e komisioneve të këshillit, në të cilin sipas rekomandimit të CSDC Durrës, u ngrit një këshill i ri mbi teknologjinë e informacionit dhe digitalizimin.⁹ Në këto konsultime kanë marrë pjesë 10 përfaqësues të OJFve të ndryshme, të cilët thirren rregullisht nga bashkia dhe këshilli bashkiak. Përkatësisht: CSDC Durrës, World Vision, Shoqata Gender Paqe e Siguri, Fondacioni "Ndihmë për fëmijet", Qendra "Sot për të ardhmen" etj. Më poshtë mund të gjenden materialet në lidhje me këto konsultime, të cilat janë të aksesueshme në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Durrës.

- <https://durres.gov.al/ngarkime/uploads/2023/06/Njoftim-per-konsultim-me-publikun.pdf>
- <https://durres.gov.al/ngarkime/uploads/2024/01/Raporti-i-D.P-per-PBA-2024-2026-compressed.pdf>
- <https://durres.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Njoftim-publik-per-konsultim-me-publikun-parkimi-Durres-1.pdf>

⁹ <https://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-durres-nr-123-date-13-07-2023/>

Përshkrimi i strukturës së qeverisjes lokale në bashkinë Durrës:

Bashkia Durrës përbëhet nga 11 njësi administrative, nga të cilat 5 janë jashtë zonës urbane: 6 njësi në Durrës, dhe Ishëm, Katund i Ri, Manëz, Rashbull dhe Sukth. Bashkia ka nën administrimin e saj qytetin e Durrësit dhe disa fshatra përreth.

Popullsia në vitin 2023 ishte rreth 250,000 banorë, nga të cilët 175,000 banorë jetojnë në qytetin e Durrësit dhe 75,000 jetojnë në njësitë administrative përreth. Numri i punonjësve të bashkisë për vitin 2024 është 1,600 persona, nga të cilët 400 janë pjesë e administratës së bashkisë dhe 1,200 janë të punësuar në njësitë shpenzuese.

Këshilli Bashkiak Durrës: Këshilli Bashkiak Durrës përbëhet nga 51¹⁰ anëtarë që vijnë nga disa forca të ndryshme politike. Të ndarë sipas gjinisë janë 27 M / 24 F. Anëtarët e KB kanë ngritur 15 komisione ([Përbërja E Komisioneve – Bashkia Durrës \(durres.gov.al\)](https://durres.gov.al)). Si organ përfaqësues aktualisht rregullon marrëdhëniet dhe ndërveprimin e tij me publikun përmes rregulloreve të brendshme të miratuara si më poshtë:

- I. Rregullore për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë Durrës.
https://durres.gov.al/wp-content/uploads/2020/05/1_RREGULLORE_E_FUNKSIONIMIT_T_KSHILLIT_T_BASHKIS_D_URRS.pdf E miratuar në mbledhjen e KB Durrës Ligji nr. 8548/1999, neni 4/2.. Duke shqyrtuar këtë rregullore e cila është e ngarkuar në faqen e internetit, vëmë re se KB ka disa të drejta dhe detyrime për të organizuar njoftimin dhe konsultimin publik (neni 129 – pika 11/c/g, neni 131-132, neni 147, neni 151-152, 154 – pika 3, neni 160 – pika 7) në marrëdhënie me grupet e interesit dhe qytetarët e njësisë së vetëqeverisjes vendore.
- II. Rregullore për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Mediat
https://durres.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/Rregullore_e_Keshillit_per_Marredheniet_me_Publikun_dhe_Median.pdf. Rregullorja përmban ndër të tjera edhe format e pjesëmarrjes, njoftimit dhe këshillimit të publikun.
- III. Bazuar në programin e Transparencës miratuar me VKB nr.572/11, datë 20.12.2018, bazuar në detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr.146/2014. Fusha e gjashtë e tij parashikon informacionin dhe procedurat e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, kuadrin rregullator vendor, listën e akteve vendore që i nënshtrohen konsultimit publik dhe nismat qytetare. Ky program parashikon bashkëpunimin e Këshillit Bashkiak dhe bashkisë Durrës. Nga një vrojtim i thjeshtë, linqet e vendosur në këtë dokument nuk hapen. (më shumë në <https://durres.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Programi-i-transparences-2019-Bashkia-Durres.pdf>)

¹⁰ <https://durres.gov.al/keshilli-bashkiak/>

¹¹ <https://durres.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Programi-i-transparences-2019-Bashkia-Durres.pdf>

7. Historiku i Procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në bashkinë Durrës

Bashkia Durrës si organ ekzekutiv përmes kryetarit ka miratuar urdhëra të brendshëm që lidhen me aspektet procedurale dhe zbatimin e Ligjit Nr. 146/2014. Sipas pikës 30.3, Koordinatorin i njoftimit dhe konsultimit publik (Specialist) ka detyra specifike për këtë pozicion. Bashkia Durrës gjatë vitit 2023 ka realizuar 19 konsultime publike¹²⁻¹³, ku kanë marrë pjesë grupe interesi, OJF, qytetarë etj. si edhe 3 konsultime në faqen e internetit për 2024 duke kryer gjithsej 22 konsultime publike.

Bashkia Durrës deri më tani ka realizuar 3 projekt akte për konsultimin publik, në të cilat në secilën prej tyre, janë dokumentuar në regjistrin elektronik dhe është respektuar afati i kohës së konsultimit prej 15-20 ditësh prej momentit të njoftimit. Këto njoftime janë bërë ndërmjet rrjeteve sociale, faqes së web-it dhe rrjeteve sociale të Këshillit Bashkiak, në të njëjtën ditë të raportuar dhe në regjistrin elektronik.¹⁴

Procedurat dhe Proceset e Njoftimit dhe Konsultimit Publik

Më poshtë po rendisim disa prej procedurave dhe proceseve ku bashkia e Durrësit dhe Këshilli Bashkiak janë të detyruar të kryejnë njoftim dhe konsultim publik për qytetarët dhe grupet e interesit:

- Konsultimet me publikun për buxhetin vjetor, sipas ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Këshilli bashkiak zhvillon seanca të konsultimeve me publikun për projekt dokumentin e parë të programit buxhetor afatmesëm (brenda muajit maj) dhe të projekt-buxhetit vjetor.
- Këshilli Bashkiak shqyrton dhe miraton projektin e parë deri te versioni final i programit buxhetor afatmesëm, afati nga 30 qershor – 30 shtator. Kryetari i NJQV-së dhe anëtarët e Grupit të Menaxhimit Strategjik realizojnë dëgjesa publike nga 1 shtatori – 30 nëntor, duke ftuar dhe Këshillin Bashkiak për projekt-buxhetin vjetor të vitit pasardhës.
- Plani i përgjithshëm vendor dhe gjithë ndryshimet që lidhen me të, proces që bëhet me konsultim publik.
- Ndryshim destinacioni i pronës publike, që është në inventarin e pronave të bashkisë. Vendimmarrja i takon vetëm Këshillit Bashkiak, ndërsa procesi realizohet nga të dyja palët së bashku ose në mënyrë të pavarur.

¹² <https://durrës.gov.al/ngarkime/uploads/2023/06/Njoftim-per-konsultim-me-publikun.pdf>

¹³ <https://durrës.gov.al/ngarkime/uploads/2024/01/Raporti-i-D.P-per-PBA-2024-2026-compressed.pdf>

¹⁴ <https://durrës.gov.al/regjistrat-elektronike/>

- Dokumente të brendshme, rregullore, plane veprimi, strategji të prodhuara nga administrata e bashkisë ose nga vetë këshilli bashkiak, para miratimit duhet t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik.
- Vendimmarrje që ndikojnë direkt në jetën e qytetarëve dhe kanë efekte financiare, p.sh. rrugë publike, parqe eolike, ku bashkia vendos vetë një pjesë të fondeve, etj.

8. Vlerësimi i efektivitetit dhe transparencës së procesit të konsultimit publik

Për të vlerësuar efektivitetin e transparencës së procesit të konsultimit publik, rrjeti POP bazuar në metodologjinë e studimit hartoi dhe shpërndau: (i) Kërkesë për informacion drejtuar bashkisë; (ii) realizoi intervista të thelluara me staf të bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; (iii) monitoroi publikimet në faqen e internetit të bashkisë dhe raporte alternative të prodhuara nga palë të treta; (iv) asistoi nga afër konsultime publike nga njoftimi i projekt-aktit deri në miratimin përfundimtar të tij.

Rrjeti POP dhe CSDC përgatitën një kërkesë për informacion¹⁵, ku përgjigja është dhënë brenda afateve ligjore me email¹⁶ dhe dokumentacion shkresor. Në lidhje me informacionin mbi “Zbatimin e proceseve të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë Durrës, për periudhën shtator 2023-maj 2024” Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik për Bashkinë Vlorë bazuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, vendosi në dispozicion informacionin që është pasqyuar në tabelën më poshtë. Gjithashtu në tabelën përmbledhëse gjeni informacion të thelluar dhe mbi përgjigjet e bashkisë dhe një vlerësim shprehet me i/e realizuar plotësisht, pjesërisht, aspak. Komente rreth gjetjeve nga monitorimi janë në dispozicion të lexuesve të këtij raporti, me qëllim për të vlerësuar efektivitetin e procedurave që zbatohen nga bashkia Durrës.

Kërkesa për informacion	Përgjigjet zyrtare nga Bashkia Korçë dhe Këshilli Bashkiak	Komente / Mjetet e verifikimit	Vlerësimi
1.Emri, kontaktet e Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe kopje të	Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në Bashkinë Durrës është Znj. Elisa Qerama E-mail: Elisa.Qerama@durres.gov.al	Për të marrë informacion mbi emërimin e koordinatorit për Konsultimin Publik, dorëzuam në Bashki 8 Kërkesat për informim, ndërmjet postës elektronike dhe postës me Rekomande. Në përgjigje na u dërgua vetëm Emri i Koordinatorit të njoftimit dhe Konsultimin Publik, nga adresa zyrtare e shkruar më lartë. Asnjë	Pjesërisht i realizuar

¹⁵ Kërkesë për Informim - “Zbatimi i proceseve të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë Durrës, për periudhën shtator 2023-maj 2024” protokolluar me nr.7844 në datën 20.05.2024 (ANEKS)

¹⁶ Kthimi i përgjigjes nga Koordinatorin i Konsultimit Publik bashkia Durrës, me email më datë 3 qershor 2024

vendimit të emërimit të tij.		informacion i mëtejshëm nuk u dha dhe as në faqen e Web-it nuk ka të bashkangjitur asnjë informacion për këtë Koordinator.	
2. <i>Linku</i> i Regjistrat Elektronik ku janë publikuar projektaktet, e Njoftimit për konsultim dhe të dhëna të lidhura me Konsultimin e Projektakteve sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, gërma a) e Ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.	Në përgjigjen zyrtare të Bashkisë është dërguar <i>linku</i> i Regjistrat Elektronik i projektakteve për Konsultim Publik, të Këshillit Bashkiak Durrës: http://www.durres.gov.al/	Në faqen e Webit të Bashkisë Durrës, disponohet informacioni në lldhje me regjistrat elektronikë, të paraqitura në linkun e mëposhtëm https://durres.gov.al/regjistrat-elektronike/	I realizuar plotësisht
3. Kopje të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me Procesin e Vendimmarrjes, të publikuara në Programin e Transparencës, sipas Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”	Në përgjigje të kërkesës sonë nga Bashkia na është dërguar: <i>Linku</i> ku publikohen planet vjetore, pjesë e Programit të Transparencës, duke bashkangjitur këto linqe. <ul style="list-style-type: none"> • www.durres.gov.al • https://durres.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Njoftim-publik-per-konsultim-me-publikun-parkimi-Durres-1.pdf • https://durres.gov.al/2023/10/12/kalendari-i-degjesave-publike-per-programin-buxhetor-afatmesem-2024-2026/ 	Përsa i përket pikes, linku i pare i ofruar nga Koordinatorja është ajo e faqes web, së Bashkisë Durrës, në të cilën pohon se këto pika janë të bashkangjitura atje. Linku i mëposhtëm: https://durres.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Njoftim-publik-per-konsultim-me-publikun-parkimi-Durres-1.pdf paraqet njoftimin për konsultimin e fundit të kryer me publikun përsa i përket rrugëve në të cilat parking-u do bëhet me pagesë. Kjo shpreh qartazi që përsa i përket pjesës së njoftimit, Bashkia Durrës i ka publikuar të gjitha thirrjet e saj. Kalendari i Dëgjësave Publike Për Programin Buxhetor Afatmesem 2024-2026 – Bashkia Durrës (durres.gov.al)	Pjesërisht i realizuar

<p>4. Mënyrat e njoftimit gjatë procesit të Konsultimit Publik që rekomandohen të kryen nga Bashkia.</p> <ul style="list-style-type: none"> •me postë elektronike; •me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues; •me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale; •me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar 	<p>Nga përgjigjet mënyrat e njoftimit janë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - afishime në standën e Bashkisë; - nëpërmjet Regjistrat Elektronik; - publikime në rrjetet sociale; - njoftime individuale; - në faqen e internetit të Bashkisë, tek kategoria “Njoftime”. 	<p>Nga monitorimi rezulton se në të shumtën e rasteve, qytetarët njoftohen për procesin e Konsultimit Publik, ndërmjet rrjeteve sociale, apo platformave lokale të pavarura nga Bashkia Durrës, sikurse (www.durreslajm.al) dhe rrjeteve sociale të saj.</p> <p>Faqja e Web-it e Bashkisë Durrë (www.durres.gov.al) edhe pse në mënyrë të vazhdueshme njofton qytetarët, shihet si një mënyrë e rrallë njoftimin në mesin e tyre.</p>	<p>I realizuar plotësisht</p>
<p>5. Mënyrat e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë Procesit të Konsultimit publik:</p> <ul style="list-style-type: none"> •me postë elektronike; •në formë verbale dhe/ose me shkrime të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike. 	<p>Sipas Bashkisë Durrës, komentet dhe rekomandimet merren në formë verbale dhe me shkrim, ndërmjet plotësimit të kërkesës në faqen zyrtare.</p>	<p>Nga monitorimi në shumicën e njoftimeve është vendosur një adresë <i>e-mail</i> për marrjen e komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të Konsultimit Publik. Gjithashtu nga verifikem e bëra përgjate punës kërkimore, në faqen zyrtare të bashkisë, tek Seksioni i qytetarëve, ndodhet nje dritare e cila cilësohet si “E drejta e informimit” dhe në anekset e saj, janë të sqaruara në mënyrë të detajshme dhe model i Kërkesës dhe Ankesës gjithashtu.</p> <p>https://durres.gov.al/e-drejta-e-informimit/</p>	<p>I realizuar plotësisht</p>

•Tjetër			
6. A ka patur raste kur është zgatur ose përsëritur faza e konsultimit?	Sipas përgjigjes së Bashkisë nuk ka patur raste të përsëritjes së fazës së Konsultimit Publik. Kjo përgjigje është e vlefshme deri në datë 4 Qershor 2024, data kur ne morrëm përgjigjet zyrtare nga Bashkia në lidhje me kërkesat për informacion që ne kishim dërguar.	Nga monitorimi na rezulton si më poshtë: Në lidhje me programin buxhetor afatmesëm 2025-2027, projektakti është pasqyruar në Regjistrin Elektronik të Konsultimeve Publike të Këshillit Bashkiak Durrës.	Pjesërisht i realizuar
7. Nese Po ju lutem na dërgoni arsyet si dhe kopje të aktit për të cilin është zgatur ose përsëritur faza e konsultimit	Nuk është i aplikueshëm deri në datë 4 Qershor 2024, pasi deri në datën e kthimit të përgjigjes nga Bashkia nuk ka patur raste të përsëritjes së fazës së Konsultimit Publik.		Pjesërisht i realizuar
8. Kopje të njoftimit për takime publike	Përgjigjia nga Bashkia: Bashkangjitur link-u i sjellur nga Bashkia Durrës https://durrës.gov.al/regjistri-i-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak/	Nga monitorimi njoftimet për Konsultimet Publike janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë. Këto njoftime përmbajnë të gjitha elementët e nevojshëm. Ka raste kur njoftimet janë më të shkurtra dhe nuk i përmbajnë të gjitha elementet, megjithatë, këto informacione pasqyrohen në kalendarët e Konsultimit Publik, të cilët janë të detajuar. Nga verifikimi tek Programi i Transparencës për vitet 2023-2024 nuk gjendet i publikuar asnjë njoftim përsa i përket këtij programi, vecse asaj cka programi mban. Nuk është i përditësuar që prej vitit 2019 https://durrës.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Programi-i-transparences-2019-Bashkia-Durrës.pdf Më poshtë njoftimet dhe modelet si shpërndahen njoftimet për dëgjesat publike në faqen <i>web</i> të Bashkisë Durrës, për këtë periudhë raportimi: Mbledhja e fundit e Këshillit Bashkiak, bërë më date 21/05/2024.	Pjesërisht i realizuar

		<p>https://durres.gov.al/2024/05/21/keshilli-bashkiak-i-durresit-zhvillon-mbledhjen-e-rradhes-ja-vendimet-e-miratuara-6/</p> <p>Gjithashtu Këshilli Bashkiak Durrës ka dhe rrjete Sociale Facebook dhe Instagram, nëpër të cilat poston thirrjet për mbledhjen e Këshillit dhe Konsultimet dhe Dëgjuesat Publike.</p> <p>Më poshtë një model se si shpërndahen njoftimet: https://www.facebook.com/share/p/QjeYAPkSr28Yv151/</p>	
9. Kopje të procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhës shtator 2023 – maj 2024	Nga Bashkia nuk na është dërguar asnjë link.	<p>Nga monitorimi na rezulton se është një link në faqen e web, paraqitur më poshtë, në të cilën janë publikuar të gjitha konsultimet publike spër vitet deri më 2022 dhe ajo më e fundit për parkimet publike më 2024.</p> <p>https://durres.gov.al/category/bashkia/keshilli-bashkiak/regjistri-i-konsultimeve-publike/</p>	Pjesërisht i realizuar
10. Kopje të projektakteve të miratuara gjatë periudhës shtator 2023 – maj 2024 shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të	Për këtë pike Bashkia Durrës nuk ka kthyer asnjë përgjigje.	<p>Sipas kërkimeve të grupit të punës CSDC Durrës, këto projekt akte, projekt vendime, ishin të publikuara në faqen e web-it të Bashkisë.</p> <p>https://durres.gov.al/regjistri-i-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak/ dhe të përmbledhura dhe ato në vijim ndodhen në këtë link</p> <p>https://durres.gov.al/projekt-vendimet-ne-proces-shqyrtimi-nga-keshilli-bashkiak/</p> <p>Këto linqe paraqesin në mlynrë të detajuar projektvendimet e Bashkisë Durrës ndër vite, ku për periudhën shtator 2023, maj 2024 janë krzer gjithsej, sipas regjistrat elektronik dhe publikimet në këto linqe 3 gjithsej</p>	Pjesërisht i realizuar

Ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”			
11. Kopje të Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes per vitin 2023	Bashkia, në përgjigje të kësaj kërkesë, nuk ka dërguar asnjë link.	Nuk ka asnjë raport vjetor në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, i vetmi raport që është, është ai i përgjithshëm i cili është më poshtë https://durres.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Programi-i-transparences-2019-Bashkia-Durres.pdf	I pa realizuar
12. Nëse ka patur ankesa në lidhje me procesin për Njoftim dhe Konsultim Publik. Nëse PO ju lutem na dërgoni kopje të ankesave.	Në institucion nuk ka të depozituar ankesa në lidhje me procesin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.	Nga qytetarët apo grupet e interesit ka ankesa për procesin e realizuar në periudhën shtator 2023– maj 2024, të cilat janë të shfaqura në regjistrin e ankesave në faqen e web-it Nga monitorimi është vërejtur se regjistri përmban ankesa lidhur me problematika të ndryshme, por jo me Konsultimin Publik. Linku si më poshtë: https://durres.gov.al/egjistri-i-ankesave-kerkesave-dhe-verejtjeve/	I realizuar plotësisht

8.1 Gjetje nga intervistat e realizuara me staf të bashkisë Durrës

Në vazhdim analiza e intervistave me përfaqësuesit e stafit të Bashkisë Durrës:

- Nënkryetari i Bashkisë
- Koordinatorja për Njoftimin dhe Konsultimin Publik
- Koordinatorja për të Drejtën e Informimit dhe Transparencës
- Përfaqësuesja e Drejtorisë së Financës
- Përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licencimit

Përsa i përket informacioneve të marra, Koordinatorja për të Drejtën e Informimit dhe Transparencës shprehu se nuk kishte informacion të mjaftueshëm mbi çështjen në fjalë dhe sugjeroi të kontaktohej Koordinatorja për Konsultimin Publik. Kjo tregon se dy koordinatoret nuk janë të informuar për punën e secilit, duke u përqendruar vetëm në detyrat e tyre funksionale. Për më tepër, Drejtorja e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit nuk ishte në gjendje të ofronte përgjigje për pyetësonin.

Në përmbledhje, e përgjigjeve të marra nga përfaqësuesit e bashkisë Durrës:

Procesi i Standardizimit të Procedurës Administrative: Ky proces është realizuar gjatë periudhës Shtator 2023 - Maj 2024. Bashkia ka zhvilluar procese të konsultimit me qytetarët, përfshirë dëgjesat publike, ku qytetarët ftohen të japin mendime dhe sugjerime. Koordinatorja për Njoftimin dhe Konsultimin Publik theksoi se ky proces ka mbi 7 vjet që realizohet.

Procedura e Njoftimit dhe Konsultimit Publik: Proceset e njoftimit dhe konsultimit publik iniciohen nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetarja e Bashkisë.

Organizimi i këtyre proceseve ndjek një procedurë të qartë: Fillimisht, projekt-akti dërgohet në Këshillin Bashkiak për miratim dhe zhvillohet një mbledhje e hapur për qytetarët. Këto mbledhje janë veçanërisht të rëndësishme për çështjet e buxhetit, ku është vënë re një rritje e pjesëmarrjes së qytetarëve në vitet e fundit. Pasi projekt-akti shqyrtohet dhe diskutohet nga Këshilli Bashkiak, drejtorja përkatëse përgatit një relacion që shpjegon detajet dhe implikimet e tij. Ky relacion publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe bëhet një njoftim për grupet e interesit dhe qytetarët. Kjo mënyrë njoftimi siguron që çdo individ i interesuar të ketë mundësinë të informohet dhe të japë komente mbi projekt-aktin. Përveç publikimit online, njoftimi dërgohet edhe në njësitë administrative qytetare për shpërndarje në komunitet. Në përfundim të këtij procesi, Këshilli Bashkiak dhe grupet e interesit angazhohen aktivisht në një diskutim të hapur dhe të gjerë. Ky bashkëpunim synon të përfshijë sa më shumë palë të interesuara dhe të sigurojë që vendimmarrjet të jenë gjithëpërfshirëse dhe transparente. Sigurimi i pjesëmarrjes së të gjithë grupeve të interesit bëhet përmes informacionit të dërguar dhe ftesave të dërguara tek organizatat lokale, bizneset, mediat lokale dhe njësitë administrative për afishime.

Format e njoftimit përfshijnë: Regjistrin elektronik, Posta elektronike (*e përdorur ndonjëherë si formë njoftimi*); Lajmërimi publik i afishuar në ambientet e bashkisë (*zyra e informimit të qytetarëve*); Lajmërimi në mediat autovizive lokale nuk bëhet në kushte kur nuk ka media: Lajmërimi në mediat sociale përfshin edhe informacionet pasi aktiviteti ka ndodhur; Lajmërimi individuale: (*Ndonjëherë përdoret si formë njoftimi*); Botim në gazetatat lokale: Asnjëherë (*në kushtet kur nuk ka gazetë lokale*)

Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik bëhet repsektivisht me anë të shënimeve nga stafi i bashkisë.

Regjistri i vendimmarrjeve dhe funksionimi i tij: Bashkia Durrës ka një regjistrë¹⁷ vendimmarrjeje, të publikuar në faqen e web-it, i cili është lehtësisht i aksesueshëm për cdo qytetar, që dëshiron të informohet në lidhje me regjistrin e vendimmarrjeve dhe apo ashtu funksionimit të tyre. Të gjithë të intervistuarit pohojnë se kohët e fundit vihet re një rritje e qytetarëve, të cilët angazhohen, duke komentuar e pyetur, sidomos përsa i përket buxhetit të PBA-së. Bashkia Durrës të gjitha konsultimet publike i ka me dyer të hapura dhe hedh njoftime që të marrin pjesë dhe grupe interesi apo qytetarë të interesuar për këto dëgjesa. Pjesëmarrësit në intervista e kanë cilësuar monitorimin e transparencës si një proces ku individët e jashtëm kanë mundësi të veprojnë si monitorues të konsultimeve publike. Këtu janë aspektet kryesore të cilat janë trajtuar: Procedura; Burimet njerëzore; Burimet financiare; Burimeve materiale; Infrastruktura e përshtatshme; Asistencë Teknike/Trajnime. Për burimet njerëzore, procedura dhe infrastruktura janë të përshtatshme dhe përbëjnë kushte thelbësore për realizimin e

¹⁷ <https://durrës.gov.al/regjistrat-elektronike/>

suksesshëm të procesit të konsultimeve publike. Megjithatë, është e nevojshme që të shtohen më shumë burime njerëzore dhe të përmirësohen kapacitetet ekzistuese për të garantuar një menaxhim më të mirë dhe një efektivitet të rritur në realizimin e këtyre proceseve. Këto përmirësime do të ndihmojnë në optimizimin e procedurave dhe në forcimin e infrastrukturës për të mbështetur një përfshirje më të gjerë dhe një transparencë më të lartë.

8.2 Gjetje nga intervistat e zhvilluara me anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Numri total i këshilltarëve bashkiak të intervistuar ishte pesë. Të gjithë të intervistuarit theksuan rëndësinë e përfshirjes së publikut dhe grupeve të interesit në procesin e hartimit dhe vendim-marrjes nga Këshilli Bashkiak. Ata e konsideruan shumë të rëndësishëm informimin në kohë të qytetarëve, si dhe këshillimin me ta gjatë këtij procesi.


Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje, përveçse është një detyrim ligjor, gjithashtu lehtëson punën e pushtetit lokal në realizimin e detyrave ndaj komunitetit. Të gjithë të intervistuarit e vlerësuan këtë proces si një pikë shumë të rëndësishme për informimin dhe këshillimin e qytetarëve.

Sa i përket informimit të qytetarëve, kontakti i tyre përmes njoftimeve dhe konsultimeve është cilësuar si shumë i rëndësishëm. Të gjithë të intervistuarit kishin njohuri për rregulloren e Këshillit Bashkiak dhe procedurën e konsultimeve publike, dhe dinin vendndodhjen e këtyre dokumenteve në faqen e internetit të Bashkisë Durrës, ku kanë bërë edhe referimet e tyre. Të gjithë të intervistuarit e kanë cilësuar të qartë dhe të plotë kuadrin ligjor për informimin dhe konsultimin publik.

Në lidhje me rekomandimet, 60% e të intervistuarve nuk shprehën ndonjë sugjerim specifik. Megjithatë, dy rekomandime kryesore u identifikuan: të bëhen sa më shumë konsultime publike dhe të respektohen me përpikmëri afatet e njoftimeve për të gjitha palët e interesuara.

Të gjithë të intervistuarit konfirmuan bashkëpunimin ndërmjet Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë për procesin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik. Ata shpjeguan se ky bashkëpunim është funksional, me këshilltarët që njoftohen për takimet përmes postës elektronike dhe që zhvillojnë takime të përbashkëta me stafin e bashkisë.

Për sa i përket infrastrukturës, 80% e të intervistuarve e vlerësuan si të përshtatshme. Në kontrast, pjesa tjetër e shprehur se infrastruktura nuk ishte e përshtatshme, pasi takimet zhvilloheshin bashkërisht me stafin e bashkisë dhe jo në mënyrë individuale apo në pika të tjera të takimeve jashtë ambienteve të Bashkisë.




A. Mjetet që përdor Këshilli Bashkiak për njoftimin e procesit të Njoftimin dhe Konsultimit Publik

- **Regjistri elektronik:** 60% e të intervistuarve u përgjigjën që të dhënat janë të ruajtura dhe në regjistrin elektronik të Bashkisë Durrës, të cilat gjenden në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës.
- **Posta elektronike:** Për këtë pikë rreth të gjithë të intervistuarit e kanë përzgjedhur si mënyrë njoftimi. E-mail si një formë zyrtare informimi përdoret kryesisht edhe për OJF dhe individë të interesuar për të ndjekur seancat e konsultimeve publike.
- **Lajmërimi publik i afishuar në ambjentet e bashkisë:** Për këtë pikë rreth të gjithë të intervistuarit e kanë përzgjedhur si mënyrë njoftimi. Lajmërimi publik afishohet në zyrën për informimin e qytetarëve, e cila ndodhet në katin I të godinës së bashkisë.
- **Lajmërimi në mediat autovizive lokale:** 40% e të intervistuarve e përzgjedhën këtë pikë, duke nënkuptuar se ky lloj informimi është përhapur kohët e fundit për arsye se janë hapur shumë faqe lokale, të tilla si Durrëslajm (www.durreslajm.com) të cilat dhe ndërmjet rrjeteve sociale të saj, informon qytetarët.
- **Lajmërimi në mediat sociale:** Të gjithë të intervistuarit e përzgjedhën këtë metodë. Mediat sociale të bashkisë përbëhen nga faqja e Facebook¹⁸ zyrtare e Bashkisë Durrës, Faqja e instagramit dhe ajo e web-it.
- **Botim në gazetate lokale:** Asnjë prej të intervistuarve nuk e zgjodhi këtë metodë lajmërimi, duke qenë se mungojnë gazetate e printuara lokale në këtë Bashki.

B. Mekanizëm monitorimi dhe raportimi për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, nëse po si funksionin ky mekanizëm.


Për këtë pikë 60% e të intervistuarve mohuan të ketë një mekanizëm të monitorimit dhe njoftimin për Konsultimin publik, ndërsa pjesa tjetër pohoi duke cilësuar se kjo ndodh dhe raportohet një herë në vit nga Sekretaria e Këshillit Bashkiak.



¹⁸ <https://www.facebook.com/share/DkcBwhtuZm8iBTwV/?mibextid=LQQJ4d>

C. A raportohet në Këshillin Bashkiak mbi proceset që rrjedhin nga ligji Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe rekomandimet që dalin prej tij? Si miratohen këto projekte:

Të gjithë të intervistuarit pohojnë që nga KB kishte raportime. 60% e të intervistuarve pohojnë që këto rekomandime i miratojnë si të përfshira në projekt buxhetin e propozuar nga Bashkia. Rreth 80% e të intervistuarve pohojnë që këto rekomandime dalin dhe si një pikë e vecantë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.



D. A ka patur raste të kthimit të projekt vendimeve nga Këshilli Bashkiak për shkak të mosrealizimit të njoftimit dhe konsultimit publik? Nëse po, specifik.

80% e të intervistuarve shprehen që nuk kanë pasur raste kthimi të vendimeve nga Këshilli Bashkiak, ndërsa 20% prej tyre shprehet me një rast specifik përsa u përket rritjes së cmimeve të shërbimeve të ofruara nga UKD për qytetarët e Durrësit, të cilëve iu rrit cmimi i pagesës së ujit, pa prezencën e tyre përgjatë dëgjësës. Në saj të cka ajo ka përmendur, në këtë pikë ky vendim është rikthyer për t’u parë edhe njëherë dhe nuk është aprovuar nga Këshilli Bashkiak në mbledhje të mëvonshme.

E. Mekanizmat që Këshilli përdor me qytetarët:

Buxhetimi me pjesëmarrje: Për këtë pikë 60% e të intervistuarve janë shprehur që ky mekanizëm përdoret gjithmonë, 20% janë shprehur që ky mekanizëm përdoret shpesh dhe pjesa tjetër e cilëson që përdoret ndonjëherë.

Seanca dëgjimore të Këshillit Bashkiak: Për këtë pikë 60% e të intervistuarve janë shprehur që ky mekanizëm përdoret shpesh, 20% janë shprehur që kymekanizëm përdoret ndonjëherë dhe pjesa tjetër e cilëson që përdoret gjithmonë.


Faqja e internetit të bashkisë: Të gjithë të intervistuarit janë përgjigjur që ky mekanizëm përdoret gjithmonë, pra njoftimet për konsultimin publik publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë¹⁹ (www.durres.gov.al)

Diskutime në mediat lokale: Të gjithë të intervistuarit janë përgjigjur që ky mekanizëm përdoret ndonjëherë, duke qenë se në këtë bashki prej vitesh mungojnë mediat (TV apo radio) lokale.

Seanca dëgjimore publike organizuar nga këshilltarët: 80% e tyre rezultojnë të thonë që ky mekanizëm përdoret ndonjëherë, ndërsa 20% e tyre thotë që nuk ka ndodhur asnjëherë.

Takime në lagje, fshatra, njësi administrative: Të intervistuarit janë të ndarë në dy pole krejtësisht të kundërta, 60% e tyre pohojnë se ky mekanizëm përdoret gjithmonë, ndërkohë që 40% e tyre mohojnë se ky mekanizëm ndodh dhe e cilësojnë që nuk ndodh asnjëherë.

¹⁹ www.durres.gov.a



Komisione këshillimore qytetare: 60% e tyre nuk kanë kthyer përgjigje ndërsa 40% e tyre deklarojnë se ndodh shumë rrallë. Bashkia Durrës ka si përberje të saj dhe KKQV. KKQV Durres (Komisioni Këshillimor Qytetar Vendor) perbehet nga aktivistë të OJFve, biznesmene, akademikë, të rinj e gra, të cilët punojnë vullnetarisht në dobi të komunitetit. Qe nga viti 2012, KKQV Durres ka marrëveshje mirëkuptimi me Bashkinë Durrës për të shërbyer si bord konsultativ. “Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike në zonën e ish-Kënetës përmes hulumtimit pjesëmarrës dhe vizual” është projekti që është zbatuar nga Komisioni Këshillimor Qytetar Vendor (KKQV). Nga kjo nxjerrim konkluzion se komisionet e Keshillit Bashkiak dhe stafi i Bashkise nuk kanë informacion për komisionet qytetare.

Konsultime me ekspertë: 80% e tyre pohojnë se ky mekanizëm ndodh shpesh ndërkohë që pjesa tjetër e cilëson ndonjëherë. Rastet e përmendura për funksionimin e këtij mekanizmi janë rastet kur kanë të bëjnë me aspekte ligjore dhe të buxhetit, ku në të shumtën e rasteve merren ekspertë nga fusha juridike dhe ajo ekonomike.

Studime mbi matjen e kënaqësisë së qytetarëve, pyetsorë online: Një pjesë dërrmuese e tyre mendojnë që ky mekanizëm përdoret ndonjëherë, ndërkohë që pjesa tjetër e cilëson si mungesë këtë mekanizëm.

Mediat sociale, platformat online ose telefonatat: 20% e kanë konstatuar si asnjëherë, 20% e kanë konstatuar si ndonjëherë, ndërkohë që pjesa tjetër nuk kanë kthyer përgjigje.

F. Mekanizmat matës për Kënaqësinë e Qytetarëve.

Përsa i përket mekanizmave matës për kënaqësinë e qytetarëve, ata e masin në njëfarë mënyrë duke check-ur alternativën ndonjëherë, duke cituar se mekanizmat janë, por jo shumica përdoren në kapacitetin e tyre të plotë.

G. Ankesat e qytetarëve dhe procesi i tyre.

Për këtë pyetje 80% e këshilltarëve kanë mohuar përsa i përket ankesave të qytetarëve duke reflektuar që nuk kanë marrë ankesa nga qytetarët ndonjëherë, ndërsa pjesa tjetër ka cituar një rast për një ankesë dhe procedimin e saj, duke u mbledhur KB për të diskutuar këtë ankesë, që sikurse e më lart u përmend ajo e rritjes së cmimit të ujit. Ndërkohë, e njëjta përqindje vlen dhe për pyetjen e transparencës në të cilën 80% nuk kanë dhënë asnjë përgjigje, ndërkohë që pjesa tjetër ka shkruar që nuk ka një transparencë të këtij numri dhe pse regjistri i ankesave ekziston në faqen e web-it të bashkisë Durrës.

H. **Vlerësimi i kapacitetit të këshillit Bashkiak.** 40% e të intervistuarve i cilësojnë si shumë të aftë, 40% të tjerë i cilesojnë si të aftë dhe pjesa tjetër (20%), i cilësojnë si disi të aftë.

I. Sfidat dhe vështirësitë që ndeshen gjatë angazhimit dhe konsultimin me publikun dhe nevoja për ta përmirësimin e këtij procesi.

Përsa i përket kësaj përgjigjeje, dominon fakti i indiferencës së qytetarëve për ndjekjen dhe angazhimit në këto mbledhje edhe pse mënyra e njoftimit gradualisht është përmirësuar. Një arsye tjetër që këshilltarët kanë listuar është dhe fakti i mosprezencës së publikut / qytetarëve në mbledhjet e këshillit bashkiak dhe mungesa e ndërgjegjësimit qytetar nga organizata të ndryshme.

Përsa i përket nevojave, të gjithë kanë thënë që kërkohet një bashkëpunim më i madh prej bashkisë, individëve dhe organizatave të ndryshme për sensibilizim dhe rritjen e këtij bashkëpunimi.

Ndër to një nga nevojat që citohet është dhe ajo e përcjelljes së problematikave nga këshilltarët dhe marrja e tyre ekuivalente në konsideratë e të dyja palëve.

J. Vlerësimi i situatës mbi zbatimin e mekanizmave për angazhimin qytetar dhe konsultimin publik

Të gjithë të intervistuarit këtë pikë e kanë cilësuar si angazhim mesatar. Duke ndërmarrë këto hapa, Bashkia Durrës mund të përmirësojë më tej efektivitetin dhe transparencën e proceseve të saj të konsultimit publik, duke garantuar një pjesëmarrje më aktive dhe të informuar nga qytetarët.

9. Përmbledhje e komenteve dhe rekomandimeve të grupeve të interesit e qytetarëve nga konsultimi publik.

9.1 Intervistat e thelluara me grupet e interesit

Me qëllim matjen e nivelit të njohurive dhe të angazhimit të qytetarëve, OSHC-ve dhe grupeve të interesit në Durrës, gjatë periudhës maj-qershor ekipi i projektit përgatiti dhe shpërndau 2 formate pyetësorësh.

U përgatit një pyetësor, i cili u shpërnda me 30 (17 F/13 M) anëtarë aktivë në komunitet, përfaqësues të grupeve të interesit, OSHC-ve lokale dhe qytetarëve të thjeshtë, përsa u përket njohurive, që ata zotëronin për konsultimin publik ose jo.

Një format i dytë pyetësori, me më pak pyetje u shpërnda online dhe u plotësua nga 111 qytetarë (88 F/23 M) me qëllim për të matur perceptimin qytetar për konsultimin publik. Në vazhdim, paraqiten të dhëna në lidhje me perceptimin e grupeve të interesit mbi këtë proces të rëndësishëm.

Përsa i përket lajmërimeve mbi konsultimin publik ndërmjet rrjeteve sociale, një numër i konsiderueshëm i përgjigjeve pozitive është identifikuar. Ky rezultat ndërlidhet me faktin se rrjetet sociale, të cilat janë më të aksesueshme nga pajisjet smartphone, krijojnë një mundësi më të shpejtë dhe efikase për informimin e qytetarëve.


Megjithatë, pjesa më e madhe e të intervistuarve raportuan se nuk kanë marrë pjesë, ose kanë marrë pjesë shumë rrallë, në konsultime publike. Kjo tregon një mungesë të dukshme të pjesëmarrjes së qytetarëve në këto procese.

Sa i përket bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak për takimet në interes të grupeve që përfaqësojnë qytetarët, të gjithë të intervistuarit konfirmuan se ekziston një bashkëpunim efektiv mes tyre. Megjithatë, kur bëhet fjalë për marrjen parasysh të rekomandimeve të qytetarëve, rezultati është më i larmishëm. Një përqindje e madhe e qytetarëve shprehen se rekomandimet e tyre janë marrë parasysh, ndërsa një pjesë tjetër shprehet negativisht, duke theksuar se rekomandimet e tyre nuk janë trajtuar si duhet.

Kur pyeten se kush ka iniciuar procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, rreth 95% e të intervistuarve kanë identifikuar Organizatën Jofitimiprurëse Lokale si burimin kryesor. Ky rezultat tregon besimin e qytetarëve në shoqërinë civile, e cila perceptohet si iniciatore e seancave të njoftimit dhe konsultimit publik. Disa qytetarë kanë përmendur gjithashtu se Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC) në Durrës i ka informuar dhe ftuar për të marrë pjesë në konsultime publike ose i ka nxitur të përcjellin shqetësimet e tyre tek vendim-marrësit.

Në lidhje me funksionimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, qytetarët kanë treguar një ndarje të qartë në përgjigjet e tyre. Rreth 55% e tyre kanë raportuar se kanë informacion të mjaftueshëm dhe janë të informuar mbi procesin dhe të drejtat e tyre për pjesëmarrje në konsultime publike. Nga ana tjetër, rreth 40% e qytetarëve kanë shprehur shqetësime dhe kanë dhënë përgjigje negative për sa i përket procesit. Një pjesë tjetër ka zgjedhur të mos japë përgjigje, e ndikuar ndoshta nga informacioni të pamjaftueshëm mbi të drejtat e tyre për të marrë pjesë dhe për të shprehur shqetësime, prioritetet dhe pakënaqësitë e tyre.

Përsa i përket rekomandimeve, qytetarët kanë shprehur bindjen se këto rekomandime shpesh bëhen vetëm për të përmbushur procedurat dhe se nuk ka një përputhje të vërtetë me veprimet dhe ndjekjen e tyre. Kjo sugjeron se ka një perceptim të gjerë që procesi i rekomandimeve është më shumë një formalitet se sa një hap real në përmirësimin e procesit të vendimmarrjes.



Sa i përket hapave të ndjekura kur nuk ka patur dakordësi për projekt-aktin, shumica e të intervistuarve kanë zgjedhur alternativën "tjetër", duke theksuar se nuk kanë pasur raste të tilla.

Pjesa tjetër ka zgjedhur të mos japë

përgjigje, e ndikuar ndoshta nga mungesa e rasteve konkrete të mosdakordësisë për projekt-aktet.

Në lidhje me vështirësitë dhe sfidat gjatë zbatimit të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, është identifikuar një problematikë e rëndësishme: mosinformimi i qytetarëve. Disa individë kanë shprehur shqetësim për afatin e shkurtër të publikimit të shpalljes për takimet e ardhshme. Këto përgjigje sugjerojnë nevojën për më shumë publikime dhe metoda interactive për të përmirësuar bashkëpunimin dhe për të minimizuar problematikat. Megjithatë, të gjithë të intervistuarit kanë vënë re një rritje të angazhimit të qytetarëve në konsultime publike, edhe pse numri i tyre mbetet i vogël. Ka një optimizëm të përgjithshëm se qytetarët po bëhen më të përgjegjshëm për të drejtat e tyre për informim dhe konsultim publik.


Rekomandime nga grupet e interesit për Procesin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik

Në përfundim të analizës, disa nga rekomandimet kryesore për përmirësimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik nga grupet e interesit:

- **Informimi i Detajuar i Qytetarëve:** Të sigurohet që qytetarët e Durrësit të informohen më gjerë për takimet dhe konsultimet publike. Kjo përfshin ofrimin e informacionit të detajuar mbi temat që do të diskutohet dhe përgatitjen e një axhende të qartë dhe të plotë për secilën mbledhje.
- **Afati i Zgjeruar për Informim:** Të ofrohet një periudhë më e gjatë për informimin e qytetarëve për takimet dhe konsultimet publike. Kjo do të lejojë qytetarët të kenë më shumë kohë për të planifikuar pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe dëgjesat publike.
- **Metoda Më të Lehta dhe Adaptive për Pjesëmarrje:** Të zhvillohen metoda më të lehta dhe më adaptive për organizimin e kohës së qytetarëve dhe për t'u siguruar që ata të kenë mundësi të shkojnë në takimet e Këshillit Bashkiak.


9.2 Perceptimet e qytetarëve përmes vlerësimit online

Për të mbledhur perceptimin e qytetarëve të ndryshëm në lidhje me njohuritë ose praktikën që kanë mbi njoftimin dhe konsultimin publik një pyetësor online u përgatit dhe shpërnda në 10



bashkitë ku Rrjeti POP punon. Në mediat sociale të Rrjetit dhe të organizatave lokale pyetësorët u shpërndanë me qëllimin për të matur impaktin që kanë qytetarët kanë mbi procesin. Në lidhje me pyetësorët e shpërndarë online në Durrës janë plotësuar 110 pyetësorë (88 F/23 M), nga të cilët 84 % janë banorë të zonës urbane

dhe 16 % janë banorë të zonave rurale të bashkisë Durrës. Më poshtë grafiku i paraqitur për ndarjen gjinore të plotësimit të pyetësorit online, ku gjinia femërore dominon me 77% krahasur me atë të Mashkullit me 23%




Nga të dhënat e paraqitura në grafikun më sipër, vërehet një përfaqësim i ndryshëm i gjinive në varësi të grupmoshave. Për grupmoshën 15-29 vjeç, femrat përbëjnë shumicën, me rreth 35 individë, ndërsa meshkujt janë të përfaqësuar me rreth 12 individë. Kjo tregon një prirje ku femrat e reja janë më të përfshira ose të pranishme në këtë kategori moshe.


Në grupmoshën 30-45 vjeç, edhe pse diferenca është më e vogël, përsëri femrat dominojnë, duke arritur në rreth 25 individë, ndërsa meshkujt janë rreth 15 individë. Kjo mund të reflektojë një angazhim të konsiderueshëm të femrave në këtë grupmoshë, krahasuar me meshkujt.

Sa i përket grupmoshës 46-65 vjeç, ndarja është më e theksuar, por femrat ende mbeten më të shumta me rreth 20 individë, krahasuar me rreth 5 meshkuj. Ky trend sugjeron një prezencë më të ulët të meshkujve në këtë grupmoshë, ose një rritje të përfshirjes së femrave edhe në moshat më të mëdha.

Në përfundim, të dhënat tregojnë një variabilitet të dukshëm në përfaqësimin gjinor në varësi të grupmoshës, ku femrat shfaqen më të përfshira në të gjitha grupmoshat e paraqitura, veçanërisht në grupmoshën e re.




Nga të dhënat e paraqitura në grafikun mbi njohuritë mbi ligjin për konsultimin publik, vihet re se pjesa më e madhe e të rinjve të moshës 15-29 vjeç sipas grafikut të mësipërm konstaton se kjo grupmoshë rezulton në numër të barabartë të atyre që dine ose jo mbi ligjin e konsultimit publik. Në grupmoshën 30-45 vjeç, ndarja është më e balancuar, ku një numër i konsiderueshëm individësh kanë njohuri, por ende mbizotërojnë ata që nuk janë të informuar. Për grupmoshën më të madhe, 46-65 vjeç, ndarja anon më shumë drejt mungesës së njohurive, duke treguar një rënie të interesit ose ndërgjegjësimit për ligjin me rritjen e moshës. Ky trend sugjeron nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit mbi ligjin për konsultimin publik, veçanërisht tek të rinjtë dhe grupmoshat më të mëdha.



Përsa i përket kësaj pyetjeje të intervistuarit janë shprehur se në të shumtën e rasteve në konsultime apo dhe në dëgjesa publike janë të sigurt që fjala e tyre nuk merret për bazë duke sjellë pasojën, që të mos kenë besim të bëhen pjesë e tyre. Në raste të tjera, janë shprehur se në të shumtën e rasteve, ata nuk janë të informuar se kur zhvillohen këto dëgjesa, ndërsa të tjerë kanë zgjedhur të mos kthejnë përgjigje.

Numër të vogël kanë ata, të cilët kanë pohuar që janë njoftuar për dëgjesat dhe të paktë janë e ata që pohojnë që ato që thonë merren ne konsideratë.



Ankesa në lidhje me ndonjë aspekt të konsultimit publik

Një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve online kanë mohuar që të kenë pasur ndonjëhere ankesa, ndërsa pjesa tjetër ka pohuar duke mos u përgjigjur asnjë që nuk ka bërë ndonjëherë

Me sa vihet re, përgjatë plotësimit të pyetësorëve fizik me ato online, nuk vihet re ndonjë ndryshim, sikurse e në grupmoshën e përcaktuar dhe në përgjigjet e dhëna. Shumica e qytetarëve mohojnë të kenë njohuri mbi konsultimin publik, ndërkohë që grupmosha 46-65 vjec pohojnë të kenë më tepër njohuri mbi konsultimin public, kjo dhe për faktin që mund të kenë njohuri më të shumta dhe prej lajmeve që ata dëgjojnë nëpër media audiovizive dhe në shoqëri. Një pikë tjetër kyçe është dhe ajo e njoftimit, mënyrës së njoftimit për dëgjesat publike, ku sikurse dhe në formularët fizik, këtu pohojnë që pjesa më e madhe e tyre, marrin informacione ndërmjet mediave sociale dhe faqes së web-it, që bashkia i poston në mënyrë sistematike. Nga një krahasim i shkurtër, dalim në konkluzionin që në të vërtetë janë të paktë ata qytetarë që kanë informacione për dëgjesat publike dhe dy mënyrat më të përhapura janë ato ndërmjet medias dhe faqes së web-it të bashkisë Durrës.

Ankesa në lidhje me ndonjë aspekt të konsultimit publik

Në lidhje me ankesat për konsultimin publik, një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve online kanë deklaruar se nuk kanë pasur ndonjëherë ankesa, ndërsa pjesa tjetër ka preferuar të mos përgjigjet në lidhje me këtë çështje.

Nga analiza e pyetësorëve të plotësuar fizikisht dhe online, nuk ka ndryshime të dukshme në lidhje me grupmoshën dhe përgjigjet e dhëna. Shumica e qytetarëve nuk kanë njohuri të mjaftueshme për konsultimin publik. Megjithatë, grupmosha 46-65 vjeçare tregon një nivel më të lartë njohurie, ndoshta për shkak të ekspozimit më të madh ndaj lajmeve në media audiovizive dhe në shoqëri.

Një çështje tjetër e rëndësishme është mënyra e njoftimit për dëgjesat publike. Si në formularët fizikë, ashtu edhe në ato online, shumica e qytetarëve raporton se marrin informacion përmes mediave sociale dhe faqes së web-it të Bashkisë, ku informacioni publikohet në mënyrë sistematike.

Nga krahasimi i të dhënave, rezultojnë se një numër i vogël qytetarësh janë të informuar për dëgjesat publike, dhe dy mënyrat më të zakonshme të informimit janë media dhe faqja e web-it e Bashkisë Durrës.

10. Konkluzione dhe Rekomandime

Konkluzione për Bashkinë Durrës

- Edhe pse bashkisë Durrës i kërkohet të garantojë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes, përmes instrumentit të konsultimit, ende nuk ka **proceduara të unifikuara**, ku pjesëmarrja qytetare të jetë një **proces transparent dhe i drejtpërdrejtë** mes administratës së bashkisë, anëtarëve të KB dhe qytetarëve për këshillimin, shkëmbimin e opinioneve për politikën, legjislacionin dhe normat që rregullojnë vetëqeverisjen vendore.
- Ky proces **nuk zhvillohet në mënyrë të unifikuar dhe në mënyrë të vazhdueshme** sipas procedurave të përcaktuara në ligj.
- Bashkia Durrës prej vitesh realizon proceset e njoftimit dhe konsultimit publik, por në **faqen e internetit** ende nuk vendoset **informacion i qartë dhe i detajuar** mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimin e debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.
- Programi i rishikuar i transparencës në bashkinë Durrës, përveç vendosjes së një personi përgjegjës në rolin e **Koordinatorit të Programit të Transparencës**, pritet të sjellë dhe ndryshime konkrete në administrimin dhe publikimin e të dhënave e dokumenteve që bashkia dhe KB, prodhojnë në funksion të rritjes së transparencës dhe vendimmarrjes.
- Përsa i përket **raportit të transparencës** mbi veprimtarinë e **KB**, në faqen eeb ndodhet ikona e raporteve, por nuk ka mundësi të shkarkohet asnjë raport. Nevojitet që ky seksion të plotësohet dhe raportet e transparencës të prodhohen dhe publikohen në mënyrë periodike.
- Në lidhje me analizën e project-akteve të realizuara me konsultim publik, mungon informacioni që shoqërohet me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

Konkluzione për Këshillin Bashkiak Durrës

- Të gjithë të intervistuarit vlerësojnë shumë të rëndësishëm informimin dhe njoftimin e qytetarëve për projekt-aktet që miratojnë anëtarët e Këshillit Bashkiak (KB). Informimi është përmirësuar përmes transmetimeve live të mbledhjeve të KB dhe rritjes së ndërveprimit me publikun përmes mediave sociale dhe faqes së internetit të këshillit.
- Këshillimi me bashkësinë, konsiderohet shumë i rëndësishëm për mbledhjen e informacionit dhe rekomandimeve që janë afër nevojave të komunitetit. Anëtarët e KB kanë qenë prezentë në shumë dëgjesa publike por bazuar në rregulloret e tyre ata duhet të marrin rol drejtues dhe t'i realizojnë proceset edhe në mënyrë të pavarur nga bashkia.

- Anëtarët e KB njohin mirë bazën ligjore dhe përpiqen të zbatojnë procedurat e parashikuara në rregulloret, megjithatë ka pengesa, që pengojnë zbatimin e plotë të këtyre procedurave në praktikë. Njohja e bazës ligjore përbën sfidë dhe kërkon kohë për t'u përshtatur me situatën reale.

Konkluzione dhe rekomandime të përgjithshme

- Proceset e njoftimit, informimit dhe konsultimit publik vlerësohen nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak Durrës si procese shumë të rëndësishme. Strukturat kryesore në Bashki, të cilat ndihmojnë në informimin e publikut, janë: këndet e informimit në ambientet e Bashkisë, faja zyrtare e Bashkisë dhe mediat sociale.
- Bashkia Durrës ka një regjistër elektronik të publikuar online, i cili përditësohet çdo vit. Raportet vjetore në lidhje me transparencën në procesin e vendimmarrjes hartohen dhe publikohen çdo vit nga Bashkia Durrës. Pavarisht arritjeve të deritanishme, realizimi i procesit të konsultimit publik ka ende nevojë për përmirësime. Kjo mund të arrihet duke nxitur interesin e qytetarëve dhe duke krijuar infrastrukturë që mundëson informimin sa më gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm nga të gjithë.
- Nëpunësit e Bashkisë dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak duhet të marrin trajnime të vazhdueshme në lidhje me detyrimet ligjore për informimin e publikut. Në këtë mënyrë mundësohet aftësimi i vazhdueshëm i tyre në lidhje me këtë kuadër ligjor dhe ndihmon në procesin e komunikimit dhe transparencës.
- Bashkia Durrës në faqen e saj te web-it përmban Programin e Transparencës dhe një regjistër elektronik si dhe atë të kerkësave dhe ankesave të përditësuar, sa herë ka shtime të saj. Kjo tregon që Bashkia Durrës është pro transparencës me qytetarët e saj.
- Për të ilustruar nevojën për përmirësim në procesin e konsultimit publik, mund të mendojmë për një qytetar që dëshiron të shprehë mendimin e tij për një projekt të ri urbanistik. Nëse informacioni është i qartë dhe i lehtë për t'u gjetur, ai do të ndihet më i inkurajuar të marrë pjesë. Këtu janë disa mënyra për të përmirësuar këtë proces:
- Përmirësimi i Infrastrukturës së Informacionit: Krijimi i një portali të dedikuar për konsultime publike, ku qytetarët mund të kenë akses në dokumentet relevante dhe të japin mendimet e tyre në mënyrë të organizuar.
- Rritja e vizibilitetit të informacionit të dhënë nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak Bashkia të gjejë mënyra të ndryshme dhe sa më të arritshme tek qytetarët për mbledhjet, vendimet dhe projektligjet të cilat do shqyrtojnë/hartojë ose të miratojnë për qytetarët e Durrësit. Kjo do të ulë numrin e mosinformimit dhe dezinformimit tek qytetarët dhe do të rrisë pjesëmarrjen e tyre.
- Rritja e Ndërgjegjësimit: Fushata të vazhdueshme informimi nëpër media sociale dhe lokale për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për proceset e konsultimit publik.
- Trajnime të Vazhdueshme: Organizimi i trajnimeve periodike për nëpunësit e Bashkisë dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak, për t'i mbajtur ata të azhornuar me praktikat më të mira dhe detyrimet ligjore.

- Pjesëmarrja
Gjithëpërfshirëse: Sigurimi i përkthimit të dokumenteve kryesore në disa gjuhë dhe ofrimi i asistencës për personat me aftësi të kufizuara për të siguruar pjesëmarrje sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse të tyre.

11. Referenca (Lista e burimeve të përdorura për studimin)

- <https://durres.gov.al/rreth-keshillit-bashkiak/>
- <https://durres.gov.al/ep-content/uploads/2009/02/Struktura-Nov-2019.pdf>
- <https://durres.gov.al/ngarkime/uploads/2009/02/Organigrama-2018.pdf>
- <https://durres.gov.al/ep-content/uploads/2023/11/Programi-i-transparences-2019-Bashkia-Durres.pdf>
- <https://durres.gov.al/regjistri-i-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak/>
- <https://www.facebook.com/share/DkcBwhtuZm8iBTwV/?mibextid=LQQJ4d>
- <https://durres.gov.al/regjistrat-elektronike/>
- <https://durres.gov.al/ngarkime/uploads/2023/06/Njoftim-per-konsultim-me-publikun.pdf>
- <https://durres.gov.al/ngarkime/uploads/2024/01/Raporti-i-D.P-per-PBA-2024-2026-compressed.pdf>
- <https://durres.gov.al/regjistrat-elektronike/>
- <https://durres.gov.al/keshilli-bashkiak/>

<https://durres.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Programi-i-transparences-2019-Bashkia-Durres.pdf>

- <https://durres.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Programi-i-transparences-2019-Bashkia-Durres.pdf>
- https://durres.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/Rregullore_e_Keshillit_per_Marredheniet_me_Publikun_dhe_Median.pdf
- https://durres.gov.al/wp-content/uploads/2020/05/1_RREGULLORE_E_FUNKSIONIMIT_T_KSHILLIT_T_BASHKIS_D_URRS.pdf
- <https://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-durres-nr-123-date-13-07-2023/>
- <https://durres.gov.al/ngarkime/uploads/2023/06/Njoftim-per-konsultim-me-publikun.pdf>
- <https://durres.gov.al/ngarkime/uploads/2024/01/Raporti-i-D.P-per-PBA-2024-2026-compressed.pdf>
- <https://durres.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Njoftim-publik-per-konsultim-me-publikun-parkimi-Durres-1.pdf>

- <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>
- <https://www.facebook.com/CivilSocietyDevelopmentCenterDurrës>
- <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>
- <https://popNetwork.al/>

12.Anekse

Aneksi 1. Kërkesë Zyrtare drejtuar Bashkisë Durrës

Aneksi 2. Pyetësi i Intervistave të thelluara me stafin e Bashkisë Durrës

Ankesi 3. Pyetësi i Intervistave të thelluara me anëtarët e Këshillit Bashkiak Durrës

Ankesi 4. Pyetësi i Intervistave të thelluara me grupet e interesit

Ankesi 5. Pyetësi për qytetarët online

Nr.14/1 prot.

Data 20.5.2024

Kërkesë për informim nr. 01

Drejtuar: **Znj. Emiriana Sako**, Kryetare e Bashkisë Durrës

E nderuar znj. Kryetare,

Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile, CSDC Durrës si pjesë e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) <https://popnetwork.al/> po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Durrës për periudhën shtator 2023 – maj 2024.

Përsa mësipër në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe nenit 6, nenit 9 dhe nenit 10 të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” kërkojmë të na informoni:

- 1) Emrin, kontaktet e Koordinatorit të njoftimit dhe konsultimit publik dhe kopje të vendimit të emerimit të tij.
- 2) Linkun e regjistrit elektronik ku janë publikuar Projektaktet, e njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, germa a) e ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- 3) Kopje të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, të publikuara në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Duke mbetur në pritje të informacionit të kërkuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të cilën mund ta dërgoni në adresën elektronike info@csdcdurres.com

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

Nënshkruar nga

Mirjam Reçi
Drejtoreshë Ekzekutive

Nr. 14/2 prot.

Data 20.5.2024

Kërkesë për informim nr. 02

Drejtuar: **Znj. Emiriana Sako**, Kryetare e Bashkisë Durrës

E nderuar znj. Kryetare,

Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile, CSDC Durrës si pjesë e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) <https://popnetwork.al/> po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Durrës për periudhën shtator 2023 – maj 2024.

Përsa mësipër në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe nenit 11 të ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” kërkojmë të na informoni:

